



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) më datë **19-20.07.2017** realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në **Institucionin Publik – Azili i pleqve “Sju Rajder” në Manastir**. Kjo vizitë u realizua në bashkëpunim me Shoqatën e Punonjësve Social të Qytetit të Shkupit, Dhomën e Psikologëve të RM-së dhe Shoqatën e Infermiereve, Akushereve dhe Teknikëve të RM.

MPN realizoi **vizitë të rregullt të paparalajmëruar** në Institucionin publik, në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit. Në përputhje me nenin 11-a, Avokati i Popullit siguron mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar dhe personave të cilët janë subjekt të torturës ose llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, ndërsa në përputhje me nenin 31-a Avokati i Popullit, për realizimin e aktiviteteve realizon vizita të rregullta dhe të paparalajmëruara në organet dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, për çka përpilon dhe dërgon raport të posaçëm.

Ekipi i MPN-së realizoi këqyrje në të gjithë objektin – në pjesën më të madhe të dhomave të gjumit për vendosjen e shfrytëzuesve, hapësirat e përbashkëta, shoqëruese dhe ekonomike-teknike. Nga këqyrja në dhomat e gjumit u konstatua se ata janë të ndarë sipas gjinisë, burra dhe gra, dhe në pjesën më të madhe të rasteve në një dhomë janë të vendosur nga dy shfrytëzues, ndërsa në disa dhoma gjumi ka edhe nga një, tre ose katër shfrytëzues në një dhomë.

Gjatë realizimit të vizitës në Azilin e Pleqve “Sju Rajder”, Ekipi i MPN-së zhvilloi më shumë biseda grupore dhe individuale me shfrytëzuesit e pranishëm. Nga bisedat e zhvilluara me shfrytëzuesit rezultoi se, në përgjithësi, ata janë plotësisht të kënaqur nga sjellja e personelit, gjithashtu janë të kënaqur edhe nga kushtet e vendosjes në Azil, si dhe nga mbajtja e higjienës së tyre.

Edhe pse kishte ankesa, lidhur me cilësinë dhe shumëllojshmërinë e ushqimit, mbahet llogari për bazën fetare gjatë shpërndarjes së ushqimit, si dhe për regjimin e posaçëm të ushqimit në raste të diabetit ose gjatë nevojës për regjim dietal të ushqimit për shkak të ndonjë dukurie ose sëmundje.

Numri më i madh i shfrytëzuesve të Azilit kanë mundësinë të lëvizin papengesë në mjedisin dhe jashtë mjedisit të Azilit, si dhe mundësi për vizitë dhe qëndrim më të gjatë në shtëpitë e tyre. Së këtejmi, mund të konstatohet se respektohet e drejta e tyre e lëvizjes së lirë, megjithatë, shënuan një vërejtje në lidhje me kufizimin e kohës së vizitave në Azil.

Së këtejmi, nga bisedat e zhvilluara me shfrytëzuesit, si dhe nga biseda e zhvilluar me drejtoreshën e Azilit, u konstatua se vizitat mund të zbatohen në periudhë konkrete kohore të ditës, përkatësisht nga ora 11:00 paradite dhe më së voni deri në ora 17:00

pasdite. Sipas rendit të shtëpisë të institucionit, vizita të shfrytëzuesve lejohen paradite në periudhën kohore nga ora 09:30 dhe pasdite nga ora 15:00 deri në ora 17:00.

MPN-ja konsideron se kufizimi i kohës së vizitës i pengon shfrytëzuesit të vendosin kontakt me familjet e tyre dhe personat e tjerë të afërm, veçanërisht për shkak se një pjesë e mirë e tyre janë të punësuar dhe të “angazhuar” me orar konkret të punës, kështu që nuk kanë mundësi ta vizitojnë Azilin në kohën e caktuar për vizita.

Për këto shkaqe, MPN-ja rekomandon të ndërpritet praktika e kufizimit të kohës për realizimin e vizitave dhe të mundësohet lirish dhe papengesë vizita në Azil, me ç’rast megjithatë do të mbahet llogari që të mos çrregullohet funksionimi normal i Azilit dhe aktivitetet e parapara të rregullta të shfrytëzuesve.

Nga informacionet, të cilat i pranoi ekipi i MPN-së nga shfrytëzuesit e Azilit, mund të konstatohet se higjiena personale në Azil është adekuate. Gjithashtu, shfrytëzuesit i marrin në kohë mjetet e nevojshme higjienike, shtroja ndërrohet një herë në javë, ndërkaq, po ashtu edhe gardëroba ndërrohet me rregull, varësisht nga nevojat e vetë shfrytëzuesve. Është siguruar larja dhe rruajtja një herë në javë, për shfrytëzuesit të cilët nuk janë në gjendje që vet ta bëjnë një gjë të këtillë, ndërkaq, shfrytëzuesit të cilët janë në gjendje që të kujdesen vet për higjienën personale, kanë mundësi të lahen më shpesh.

Nga bisedat e zhvilluara edhe me drejtoreshën e Azilit, rezultoi se shfrytëzuesve nuk u mundësohet që gjatë gjithë të kenë qasje deri te uji i nxehtë, përkatësisht në Azil uji i nxehtë mund të shfrytëzohet vetëm në periudhën nga ora 11:00 paradite, më së voni deri në ora 14:00 pasdite. MPN-ja konsideron se duhet të ndërpritet praktika e këtillë dhe t’u mundësohet shfrytëzuesve të Azilit shfrytëzim i përhershëm i ujit të nxehtë, në mënyrë që papengesë t’i kryejnë nevojat e tyre themelore higjienike.

Nga biseda e zhvilluar me drejtoreshën dhe shfrytëzuesit e Azilit, ekipi i MPN-së konstaton se drejtoresha i viziton dhe realizon rregullisht takime të drejtpërdrejta me shfrytëzuesit të cilët direkt mund të ankohen për çfarëdo qoftë problemesh lidhur me trajtimin ose realizimin e të drejtave të tyre. Megjithatë, nuk është inkorporuar sistemi i ankesave ku çdo ankesë do të dokumentohej në mënyrë të veçantë dhe do të evidentohej secila nga masat e ndërmarra për analizimin e të njëjtës.

Si rezultati i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport të posaçëm, në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe drejtoreshës së institucionit publik, me qëllim të eliminimit të rreziqeve dhe mangësive.